

Teksti për filmin

Gjuha : shqip

Si quhesh ti?

Një film për grupin e lojës me fëmijët prej tre vjeç

(intervistë me udhëheqësen e grupit të lojës)

„Ti udhëheq që shumë vjet grupet e lojës në Dübendorf. Pse mendon ti që grupet e lojës janë me rëndësi?

« Sot fëmijët rriten pjesërisht shumë të izoluar në familje të vogla. Më herët në familje të mëdha, fëmija kishte raporte me disa të rritur. Ai mund të dilte jashtë në mënyrë spontane dhe atje të takonte fëmijë të tjerë. Sot nëna duhet gjithçka të organizojë. Jashtë ka shumë rreziqe. Unë isha më herët shpesh në këtë shtëpi në këtë kopsht (ku tash është grupi i lojës) sepse këtu banonin gjyshërit e mi. Ne kishim shumë mundësi ; ne mund të luanim në rrugë dhe askush nuk duhej të kishte frikë për shkak të komunikacionit. Ne shkonim vetë në mal. Ne luanim me baltë në përrua, sot ai është mbuluar. Gjithkund po ngushtohet ambienti për fëmijët. Ku ne kishim liri, sot nënat duhet që fëmijët t’i kufizojnë dhe të organizojnë gjithçka për ta. Me këtë grupi i lojës është një simptomë e kohës së sotme. Unë dëshiroj që në grupet e lojës të ofroj një ambient i lirë, të cilin sot fëmijët nuk mund ta përjetojnë jashtë. Grupi i lojës është edhe një shansë për nënat dhe fëmijët që t’i shpërthejnë kornizat e një familjeje të vogël dhe të dalin jashtë. Secili fëmijë ka nevojë për një masë tjetër përkrahjeje dhe ngrohtësie dhe këte dua t’ua ofroj fëmijëve. Unë dëshiroj tu ofroj vetëm aq ndihmë sa ata vërtet kanë nevojë, në mënyrë që ata vetë t’i ndihmojnë vetvetes më tutje. Kështu, unë u ofroj një ofertë të madhe në material, një ambient të gjerë të lirë dhe kufinj krejt të qartë. Secili fëmijë duhet që nga oferta përkatëse, në kohën e tij dhe sipas zhvillimit të tij, të mund të marrë çka ai ka nevojë. Ajo çka punën time e bën interesante, është që unë nuk duhet të ndjek një program të caktuar, por të lejoj të ndodhë, të vëzhgoj dhe të gëzohem për zhvillimin e fëmijës.

(Teksti i folëses i shpërndarë në film)

Secili fëmijë e bën në mënyrën e tij rrugën për tek fëmijët e tjerë. Disa veprojnë aktivisht, të tjerët shikojnë së pari dhe shkojnë më vonë tek të tjerët.

Nganjëherë fillimi në grupin e lojës nuk është i thjeshtë për nënën dhe fëmijën.

Udhëheqësja mund të përkrahë fëmijën në procesin e shkëputjes. Ajo megjithatë nuk mund t’ia marrë dhembjen e ndarjes. Ajo megjithatë merr pjesë, është aty për fëmijën dhe në këtë ndihmë mund ta bëjë këtë hap vetë. Nganjëherë është për një fëmijë thjesht ende herët dhe është më mirë të rrijë edhe disa muaj në shtëpi, bashkë me një apo dy fëmijë të tjerë. Këtu ka nevojë për mirëkuptim nga të gjitha anët. Por nëse e ka bërë këtë hap, i qelen atij shumë dyer për të luajtur dhe bërë diçka me fëmijët e tjerë.

Edhe për nënat, grupi i lojës është një vend ku mund të vijnë në kontakt me të tjerët, për të krijuar një rrjet të ri të miqësive. Nënat njihen mes vete përmes bisedave, fëmijët përmes lojës dhe veprimit të përbashkët.

Fëmijët i ndihmojnë njëri-tjetrit, mësojnë nga njëri-tjetri dhe kështu rriten pranë njëri-tjetrit. Fëmijët i japin njëri-tjetrit reciprokisht impulse për të mësuar dhe provuar.

Në grupin e lojës fëmijët gjejnë shokë dhe shoqe për të luajtur dhe për të qenë së bashku. Ka edhe momente të vështira në grupin e lojës. Nëse të rriturit u japin kohë fëmijëve, ata gjejnë për shumëçka zgjidhje. Nëse kjo u besohet, ata mund të mësojnë nga përvojat e tyre dhe të rriten, edhe nëse nganjëherë ka lot.

Të jesh një herë shok/shoqe, pastaj të jesh i përjashtuar, të vendosësh për të tjerët, pastaj përsëri të nënshtrohesh, rolet në grupin e lojës ndërrohen shpejt.

Ta prekësh një udhëheqëse është me shumë rëndësi. Fëmijët në këtë moshë ndjejnë më shumë përmes duarve dhe veprimit, sesa përmes gjuhës. (Për këtë arsye mund të pranohen edhe fëmijët e huaj pa probleme edhe nëse ende nuk dinë gjermanisht.)

Nëse fëmijët ndjehen mirë në grupin e lojës, atëherë edhe fëmijët e turpshëm guxojnë diçka dhe provojnë.

Secili fëmijë ka nevojë për një masë tjetër ngrohtësie dhe përkrahjeje dhe një përkujdesje tjetër. Udhëheqësja e grupit jep vetëm aq shumë ndihmë sa fëmija t'i ndihmojë vetë vetvetes.

Fëmijët mund të provojnë në një ambient të mbrojtur se çka krejt veç mund të bëjnë vetë. Ata mësojnë të ndjejnë, sa mund të guxojnë.

Në shumë grupe të lojës nënat ose baballarët janë aty. Kështu fëmijët mund të ndërtojnë raporte me të rritur të ndryshëm. Prindërit kanë rastin që gjatë kësaj kohe në qetësi t'i përjetojnë fëmijët e tyre në lojë me të tjerët.

Përgatitja më e mirë për jetën është ta kesh luajtur bollshëm atë. Loja është jetë. Ka nevojë vetëm për pak material të thjeshtë. Kjo mund të përshtatet gjithnjë me nevojat e reja dhe kështu ngritet një lojë e re.

Lëvizja është për fëmijët e moshës së grupit të lojës me rëndësi jetësore për zhvillimin trupor dhe mendor.

Nganjëherë fëmijët kanë nevojë për qetësi dhe tërhiqen prapa. Nga momentet e mërzisë krijohet gjithnjë përsëri diçka e re.

Fëmija do që ta zbulojë botën që e rrethon me të gjitha shqisat. Ai mëson përmes kapjes dhe prekjes-të kuptojë.

Në grupin e lojës nuk duhet të prodhohen produkte të bukura dhe perfekte. Me rëndësi është shumë më tepër përjetimi, gëzimi në veprim dhe të provuarit.

Sot ka nevojë për grupet e lojës në mënyrë që të gjithë fëmijët të kenë një ambient të lirë të qeshin dhe të nervozohen, të lidhin shoqëri dhe të grinden, të jenë krijuar dhe nganjëherë të mos bëjnë asgjë dhe të provojnë shumë.